



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 357 Prot

Tiranë, më 27, 11, 2014

VENDIM Nr. 357, datë 17.11.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 17.11.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në lidhje me zbatimin e projektit "Rikonstruksioni i rrugës hyrëse në Parkun Arkeologjik të Amantias",

VENDOSI:

- I. Të miratojë spostimin e sipërfaqes së parkimit në pozicionin ku, nga rruga Ploçë-Sevaster degëzohet rruga për në hyrjen e Parkut të Amantias dhe për në Amonicë, sipas propozimeve të arkeologëve të Institutit të Arkeologjisë, që po realizojnë në këtë zonë projektin " Amantia" .
- II. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK- Vlorë në bashkëpunim me arkeologët e Institutit të Arkeologjisë, që po realizojnë në këtë zonë projektin " Amantia" .
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO